

## Thirrje për Aplikim – Gara për Ese

Instituti GAP në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane në Kosovë, në kuadër të projektit “Women’s Structural Unemployment in Kosovo” organizon një garë për ese për të rinjtë e Kosovës në përpjekje për të shfrytëzuar kreativitetin e tyre për promovimin e një kulture gjithëpërfshirëse pa paragjykimet gjinore në profesione.

**Tema e përgjithshme:** “Paragjykimet gjinore në profesion”

*Tema të mundshme:*

- *“Tregoni ndonjë ngjarje, kur një person punon në një profesion që në Kosovë paragjykohet si jo-adekuat për gjininë e personit. Në çfarë sfida hasin ata apo ato, dhe si duhet tejkaluar këto paragjykimet?”*
  - *Për shembull kur një grua punon si auto-mekanike, shofere e autobusit/taxit, programuese apo në ndonjë profesion të dominuar nga burrat, përkundër një burri që punon si infermier, edukator etj. - profesione të dominuara nga gratë.*
- *Argumentoni se si mund të paragjykoheni ju me përzgjedhjen e një profesioni që dominohet nga gratë ose burrat?*

Inkurajoheni të krijoni temën dhe argumentet tuaja nga çështjet që iu preokupojnë më së shumti, ndërsa çështjet e mësipërme t’i merrni vetëm si inspirim.

Publikime në lidhje me paragjykimet sikurse dallime gjinore në Kosovë mund të gjeni në faqen e Institutit GAP (<http://www.institutigap.org/publikime>).

### Udhëzimet për shkrim:

- Të drejtë konkurrimi kanë nxënësit e klasave 10, 11, dhe 12.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe jo të kopjuara.
- Shkrimet duhet të shkruhen nga një ose dy autorë.
- Shkrimet duhet të jenë deri në 750 fjalë.
- Nëse përdorni të dhëna në shkrim, duhet të iu referoheni qartë burimeve prej të cilave vijnë.

### Dorëzimi:

- Shkrimet duhet të jenë të shkruara në mënyrë elektronike (MS Word), dhe duhet të dërgohen në emailin [info@institutigap.org](mailto:info@institutigap.org).

- Në titullin e-emailit (Subject) shkruani **Ese për paragjykimet gjinore, Emri dhe Mbiemri**.
- Afati i fundit për dorëzim të shkrimeve është më **10 dhjetor 2020** në mesnatë.

### Formati i Shkrimeve:

- Hyrje
  - Paragrafi hyrës duhet të përfshijë qëllimin e shkrimit, duke i njoftuar lexuesit rreth temës kryesore të tij. Nuk duhet përdorur të dhëna ose fakte thelbësore që mbështesin argumentet tuaja në këtë seksion.

### Përmbajtja

- Vendosni të gjitha të dhënat dhe faktet këtu. Organizoni idetë në sa më shumë paragrafë të nevojshëm që mbështesin qëllimin e shkrimit tuaj. Nëse keni tri argumente, shkruani ato në tre paragrafë duke i radhitur sipas rëndësisë dhe potencialit për t'i mbështetur ato.

### Përfundimi

- Mos vendosni informacione apo të dhëna të reja në këtë paragraf. Vetëm përmbledhjeni mirë shkrimin duke ripërmendur argumentet kryesore të tij dhe duke sinjalizuar fundin e tij apo duke bërë një "thirrje për veprim" nëse shkrimi juaj do të shkruhet në atë mënyrë që të bind lexuesit të vepronjë kundrejt diçkaje.

### Vlerësimi i shkrimeve:

Instituti GAP do të përzgjedhë një panel vlerësues nga tre analistë dhe hulumtues brenda organizatës.

Paneli vlerëson në mënyrë të pavarur të gjithë finalistët në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- **Kreativiteti** (eseja përmban ide kreative dhe origjinale)
- **Struktura dhe kuptueshmëria** (eseja duhet të jetë e shtjelluar mirë, të ketë ndërlidhje me temën, dhe të ketë një strukturë të qartë)
- **Stili i shkrimit, gramatika, drejtshkrimi, pikësimi dhe citimi**

Çdo anëtar/e i/e panelit vlerësues do të lexojë dhe vlerësojë përmbajtjen e përgjithshme dhe thelbin e shkrimit dhe pastaj do të notojë me pikë pesë shkrimet më të mira.

Fituesit do të lajmërohen veçanërisht.

### Çmimet:

Nxënësve fitues do të iu dhurohen kuona për blerje të librave në ndonjë librari të vendit

Vendi i parë: kupon në vlerë prej 150 Euro dhe certifikatë

Vendi i dytë: kupon në vlerë prej 120 Euro dhe certifikatë

Vendi i tretë: kupon në vlerë prej 100 Euro dhe certifikatë

Vendi i katërt: kupon në vlerë prej 80 Euro dhe certifikatë

Vendi i pestë: kupon në vlerë prej 70 Euro dhe certifikatë